

COVID-19, Masa fiskale në Europë

Përhapja e Covid -19 po detyron qeveritë në të gjithë botën të marrin masa për të ri-marrë kontrollin mbi ndikimin njerëzor të këtij virusi. Edhe pse të nevojshme, këto masa po shkaktojnë pengesa madhore për individët, familjet, bizneset dhe ekonominë globale në përgjithësi.

E vetëdijëshme për ndikimin e rëndësishëm të pandemisë në ekonomi, qeveria shqiptare po prezanton masa për të kufizuar ndikimin ekonomik. Ndëkohë që po diskutohen më shumë masa fiskale që pritet të publikohen në javët e ardhshme për taksapaguesit shqiptarë, PwC Albania ka përmbledhur disa masa fiskale që vende të tjera europiane po ndërmarrin për të zvogëluar ndikimin e Covid-19 në ekonomi dhe në ndihmë të situatës financiare të tatimpaguesit të tyre.

Shteti	Masa	Detaje
Belgjikë	Shtyrja e afatit	Shtyrja e pagesave mund të kërkohet duke paraqitur një kërkesë zyrtare pranë autoriteteve kompetente (ekziston një mundësi për ta shpërndarë pagesën në periudhat e ardhshme). Dënimet mund të hiqen për pagesa të vonuara tatimore.
Belgjikë	Ndihma Sociale	Individët e vetëpunësuar mund të kompensohen nëse aktiviteti i tyre ndërpritet për më shumë se një javë.
Danimarkë	Shtyrja e afatit	Afatet për Tatimin në Burim, TVSH-në dhe TAP shtyhen përkatësisht për katër, një dhe pesë muaj.
Greqi	Shtyrja e afatit	Afati për pagesa të TVSH-së dhe mbledhja e borxheve në lidhje me TVSH-në është pezulluar për bizneset e prekura nga COVID-19.
Greqi	Ndihma Sociale	Mbështetje për punonjësit në kompani që janë mbyllur përkohësisht, përfshirë kompensimin financiar dhe mbulimin e sigurimeve. Dhënia e lejes për qëllime të veçanta për punonjësit që janë prindër.
Greqi	Shtyrja e afatit	Zgjatja e afatit ose pezullimi i pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore.
Greqi	Shtyrja e afatit	Zgjatja e afatit për deklaratën e korrigjimit të metrave katrorë që kanë të bëjnë me deklaratat e taksave të pasurive të paluajtshme deri më 30 qershor 2020.
Irlandë	Tjetër	Aktivitetet e zbatimit të borxhit të NVM-ve pezullohen deri në një njoftimin të mëtejshëm.
Irlandë	Tjetër	Më pak formalitete doganore për produktet Farmaceutike dhe Barnat, për të lehtësuar importin dhe furnizimin e pandërprerë të tyre.
Irlandë	Ndihma Sociale	Punëtorët e larguar nga puna do të marrin një pagesë prej 203 EUR / javë për një periudhë prej gjashtë javësh.
Itali	Zgjatje e afatit	Pagesat për Tatimin në Burim, TAP dhe TVSH shtyhen deri më 31 maj.
Itali	Ndihma Sociale	25bn EUR janë siguruar për të forcuar shërbimet e ndihmave sociale të ofruara nga shteti.
Letoni	Shtyrja e afatit	Pagesat e detyrimeve tatimore mund të shtyhen për një vit.
Lituani	Shtyrja e afatit	Tatimpaguesit mund të kërkojnë nga autoritetet tatimore të paguajnë taksat e tyre me këste ose të vonojnë pagesat tatimore.
Lituani	Shtyrja e afatit	Afati është shtyrë me dy javë për pagesat paraprake të tatim fitimit.
Lituani	Tjetër	Tatimpaguesit mund të mos paraqesin deklaratë tatimore nëse nuk kryejnë ndonjë aktivitet biznesi.



Shteti	Masa	Detaje
Holandë	Shtyrja e afatit	Afatet e pagesave fiskale mund të shtyhen për kompanitë e prekura.
Holandë	Ndihma Sociale	Përfitimet e papunësisë me kohë të pjeshme janë në dispozicion për orë të reduktuara të punës.
Norvegji	Ndryshimi i taksave	Pronarët e kompanive me deficit do të jenë në gjendje të shtyjnë pagesën e taksës së pasurisë.
Norvegji	Ndryshimi i taksave	Kompanitë me humbje mund ti rialokojnë humbjet e tyre kundrejt tepricës së tyre të tatuar në vitet e kaluara.
Norvegji	Ndryshimi i taksave	Detyrimi i pasagjerëve ajror do të shfuqizohet për fluturimet që hyjnë në fuqi nga 1 janari 2020 deri më 31 tetor 2020. Të gjitha detyrimet që lidhen me aeroportin në Norvegji gjithashtu do të shfuqizohen deri më 30 qershor 2020.
Rumani	Shtyrja e afatit	Afati i paraqitjes së deklaratave tatimore për periudhën 25 mars - 25 prill 2020 shtyhet.
Rumani	Ndryshimi i taksave	Do të zbatohet një mekanizëm i ri për rimbursimin e TVSH-së që synon shlyerjen e shpejtë të detyrimeve, duke filluar nga 1 prill 2020.
Rumani	Shtyrja e afatit	Pagesat e taksës për ndërtesën, tokën dhe automjetet shtyhen për tre muaj.
Spanjë	Shtyrja e afatit	Një shtyrje për pagesat tatimore do t'u jepet automatikisht të gjitha atyre deklaratave tatimore (përfshirë deklaratat e TVSH-së) me një afat midis 13 mars 2020 dhe 30 maj 2020, të dyja përfshirë, për detyrimet tatimore deri në 30,000 Euro. Si kërkesë e detyrueshme debitorët tatimorë nuk mund të kalojnë gjashtë milion Euro xhiro gjatë vitit të mëparshëm, d.m.th. vitit 2019.
Spanjë	Shtyrja e afatit	Detyrimet tatimore për NVM-të dhe individët e vetëpunësuar shtyhen pa interes për 6 muaj.
Korea e Jugut	Ndihma Sociale	Planifikohet të rriten pensionet me 20%, të sigurohet mirëqenia për prodhuesit e bizneset e vegjël dhe të mundësohen programe të punësimi për të promovuar mbajtjen e vendit të punës dhe trajnimin për punë.
Mbretëria e Bashkuar	Shtyrja e afatit	Afatet e pagesave të TVSH-së për bizneset e prekura shtyhen sipas kërkesës. Bizneset dhe individët e vetëpunësuar në vështirësi financiare dhe me detyrime tatimore të papaguara mund të jenë në gjendje të shtyjnë pagesën e taksave sipas skemës "koha për të paguar".
Mbretëria e Bashkuar	Ndryshimi i taksave	Taksat e pronave të biznesit do të zvogëlohen për industrinë e shitjes me pakicë dhe të udhëtimit.

Për diskutim të mëtejshëm, na kontaktoni:

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k
Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Tel: 355 4 22 90 700
Email: pwc.albania@al.pwc.com
Web: www.pwc.com/al

Loreta Peçi
Tax and Legal Services
loreta.peci@pwc.com

Erold Kamberi
Tax and Legal Services
erold.kamberi@pwc.com



www.pwc.com/al. Ky informacion ka për qëllim një përditësim të përgjithshëm për personat e interesuar dhe nuk duhet të përdoret si bazë për vendimmarrje. Për detaje të mëtejshme, ju lutemi të kontaktoni PwC Albania në: pwc.albania@al.pwc.com

Të gjitha të drejtat e rezervuara. PwC i referohet firmës anëtare shqiptare, dhe ndonjëherë mund t'i referohet edhe rrjetit PwC. Çdo firmë anëtare është një entitet juridik i veçantë. Ju lutemi të shikoni www.pwc.com/structure për detaje të mëtejshme.